



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT



Nr. protokolli: 220/25
Data: 18.03.2025

Bazuar në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023, Neni 5, si dhe në Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.313/2025 të datës: 14.03.2025. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2024/25.

- **Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- **Numri i bursave jashtë vendit - 15 (pesëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë) për student/e për vendet e BE-së;

Bursa për studentë brenda vendit

Numri i bursave për fushat e studimit:

Drejtimit deficitare	Numri i bursave Baçelor	Numri i bursave Master
Drejtimi: Matematikë	2	1
Drejtimi: Kimi	2	1
Drejtimi: Fizikë	2	/
Drejtimi: Biologji	3	1
Drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	2	/
Drejtimit: Shkenca Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike dhe inxhinieri, Inxhinieri Kompjuterike dhe sofuerike	15	3
Fakulteti i Ndërtimtarisë: Gjeodezi	2	/
Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e përgjithshme	15	/
Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet – Stomatologji	4	/
Fakulteti i Mjekësisë dhe kolegjet –Farmaci	4	/
Fakulteti i Arkitekturës dhe kolegjet: Arkitekturë, Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor	5	/
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Automatikë dhe Robotikë	3	/
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Elektronikë	2	1
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Mekatronikë	2	/

Bursa për studentë jashtë vendit

Mjekësi	5	0
Arkitekturë	1	1
Shkenca kompjuterike	2	1

Bursa për studentë të vendeve të Bashkimit Evropian

Drejtime të ndryshme:	5	0
-----------------------	---	---

I. Kriteret vlerësuese

I.1. Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, më përparësi nota më e lartë;

I.2. Në kushtet të njëjta të notës mesatare, përparësi u jepet studentëve me gjendje të rëndë sociale, të cilat janë:

I.2.1 Fëmijë të dëshmorëve

I.2.2 Fëmijë të martirëve

I.2.3. Fëmijë të invalidëve

I.2.4. Fëmijë të veteranëve

I.2.5. Fëmijë të ish burgosurve politikë

I.2.6. Fëmijë të familjeve me asistencë sociale

I.2.7. Fëmijë pa njërin, apo të dy prindërit

II. Kandidatët duhet të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë

III. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

III.1. Dëshmia e regjistrimit të vitit të studimeve me certifikatën e provimeve;

III.2. Dëshmia se është banor i Komunës së Vushtrrisë (Ekstraktin e lindjes);

III.3. Dëshmia se nuk merr bursë apo pagë nga buxheti i Kosovës;

III.4. Dëshmia se është fëmijë i dëshmorit, martirit, invalidit të Luftës të UÇK-së, veteranit të Luftës së UÇK-së, ish të burgosurit politik, dhe se është nga familja me gjendje të rëndë ekonomike- sociale;

Vëmendje:

- Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen;
- Nëse nuk ka kandidatë student/e të mjaftueshëm në një fushë, atëherë bursa e mbetur kalon te fushat tjera, së pari brenda kategorisë pastaj brenda konkursit bazuar në notën mesatare;
- Studentët jashtë vendit mund të aplikojnë vetëm në kategorinë: Bursa për studentë jashtë vendit;

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data: 18.03.2025 - 01.04.2025

Aplikacioni merret dhe i plotësuar dorëzohet në sportelet e katit të parë në Komunën e Vushtrrisë (çdo ditë prej orës: 8:00- 16:00)

Afati i ankesave:

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës komunale, kanë të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimi të listës jo përfundimtare.

Publikimi i vendimit:

Njoftimi do të bëhet në Webfaqe të komunës dhe në tabelën e shpalljes në komunë.



Drejtori i DKA-së,
Albanez Tahiraj